

R A P O R T

Për datën 3.10.1991 Hajvali

Protesta filloi në kohën e caktuar në ora 8<sup>30</sup>, para shkollës ishin të grumbulluar masovikisht nxënësit, arsimtarët dhe prindërit. Për nga masoviteti dhe numri i pjesëmarrësve në këtë protestë ishte i njëjtë me numrin e datës 2.10.1991. Gjatë protestës u lexuan kërkesat e parapara si dhe u lexuan dy tekste nga përfqësuesi i prindërve dhe i nxënësve. Përmbajtje e teksteve me përpikëri ka respektuar karakterin e protestës. Protesta kaloi pa ndonjë incident, rreth lokalit të shkollës u vrejten policia serbiane por ata nuk hyn në oborrin e shkollës dhe nuk penguan protestën.

U respektua edhe intervali kohor i protestës, nxënësit, arsimtarët dhe prindërit u shpërndan në mënyrë të qetë dhe pa ekcese.

Hajvali

Më 3.10.1991

Këshilli për informim  
i shkollës fillore "Shk-  
endi" Hajvali

  
M. Gjinkoraj